



Viti para përgatitës i profesioneve Gjuha + Integrimi

Viti para përgatitës i profesioneve Gjuha + Integrimi është një ofertë e qytetit të Cyrihut që i dedikohet të rinjve të ardhur rishtas në Zvicër. Ata këtu mësojnë në mënyrë intensive gjuhën gjermane, ata mësojnë që vetvetiu në mënyrë të pa varur të organizojnë jetën e përditshme dhe në këtë mënyrë ata përgatitën të mësojnë ndonjë profesion ose të përgatitë për ndonjë vend pune.

Kushtet e pjesëmarrjes

- moshë 15 – 21 vjeçare.
- të jetojnë në qytetin e Cyrihut.

Përmbajtja

- Te flasni gjuhën gjermane, të kuptojnë atë, dhe ta shkruajnë atë.
- Informacion mbi jetën dhe punën në Zvicër.
- Trajtohen kompetencat për jetën e punës.
- Arsimin i përgjithshëm.
- Mbështetje për arsimimin e mëtejshëm, për vend mësimi profesionale, për vend pune.

Organizimi

BVJ (viti para përgatitës i profesioneve) Gjuha + Integrimi fillon në gusht dhe zgjat një vit. Fillimi gatë viti shkollor është i mundur vetëm në disa kushte të caktuara. Në shkurt fillojnë para kurset me një ofertë të reduktuar.

Pushimet

Pushimet shkollore orientohen në planin e pushimeve të Volksschule (shkollës popullore) të qytetit të Cyrihut.

Dëftesat

Në shkurt dhe në qershor ju jepet dëftesa. Pas të tjerash ju do të keni mundësinë të merrni një diplomë të pranuar internacionale të gjuhës të orientuar në nivelin e njohurive tuja gjuhësore.

Shpenzimet

Pagesa për lajmërim është Fr. 100.- dhe duhet paguar para fillimit të kursit. Kjo pagesë nuk kthehet. Pagesa për shkollë dhe material shkollor është maksimalisht Fr. 2'400. Mundë të behët kërkesa për zvogëlim të pagesës.

Lajmërimi

Na dërgoni formularin për lajmërim të plotësuar krejtësisht. Pastaj neve ju kontaktojmë.

Cyrih, 2017